

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rrustem Begolli, me sekretaren juridike Sanije Troshupa, në çështjen penale kundër të pandehurit A.S, nga P, për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm PP/II.Nr.6891/2017, të dt: 02.02.2018, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë për dhënien e urdhrit ndëshkimor PP/II.Nr.6891/2017, të dt: 02.02.2018, më **23.04.2018**, jashtë seancës, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP/II.Nr.6891/2017, të dt: 02.02.2018, dhe gjykata nxjerr këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri:

A.S, nga i ati F, i lindur me datë ..., me vendbanim në fshatin .., Rr."B", Komuna P, me numër personal..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

S e p s e: Me datë 09.11.2017, rreth orës 08:10h, i pandehuri derisa ishte duke e drejtuar automjetin e tij, "Audi 80/89", ngjyrë e zezë, me targa ..., në Rr."Shkupi", në lagjen Veternik, në Prishtinë, nga pakujdesia duke menduar me mendjelehtësi se deri te aksidenti nuk do të vij, ka rrezikuar jetën e njëjërëzve duke e shkel Ligjin mbi Trafikun Publik, duke vepruar në kundërshtim me nenin 152 par. 1, të Ligjit për Sigurinë e Komunikacionit Rrugor, Ligji Nr.02/L – 70, në atë mënyrë që duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes së kushtëve dhe rrethanave të krijuara në rrugë, duke zhvilluar shpejtësi të madhe, të pakontrolluar dhe të pasigurtë, humb kontrollin e automjetit dhe fillon të bartet duke lënë gjurmë, ku godet skajoren e rrugës, në anën e majtë dhe pastaj kalon jashtë rrugës djathtas, ku fillimisht e godet dheun dhe përfundon mbi automjetin "VW Golf", ngjyrë hiri, i cili në ato momente kishte qenë duke u nisur që të lëvizë nga pozita e parkingut, me ç'rast dëmtime të lehta trupore që kanë shkaktuar pasoja të përkohshme të shëndetit, kanë pësuar M.V, Z.V, E.V dhe A.M;-

Me këtë ka kryer veprën penale, Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve 7, 17, 23, 41, 43, 46 të KPRK-së, si dhe neneve 365 dhe 495 të KPPRK-së, të pandehurit A.S i shqipton këtë:

DËNIM ME GJOBË

I pandehuri: **A.S** dënohet me gjobë në shumë prej **600.00 € (gjashtë qind euro)**, të cilën dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata të njëjtin do ta ekzekutoj duke i caktuar nga 1 (një) ditë burgimi për 20 (njëzet) €, të gjobës.

Obligohet i pandehuri që të paguaj shpenzimet procedurale dhe atë për ekspertizën mjeko ligjore shumë prej **50€**, për ekspertizën e komunikacionit shumë prej **40.88€** si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej **20€**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarit: E.V, Z.V, M.V dhe A.M që të gjithë, me vendbanim në lagjen V., Rr.”Sh”, në P, për realizimin e kërkesës pasuror juridike, udhëzohen në kontest të regullt civilo – juridik.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me PP/IL.Nr.6891/2017, të dt: 02.02.2018, ka akuzuar A.S, se ka kryer veprën penale – Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, dhe njëherësh nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrit ndëshkimor, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal, lidhur me arsyeshmërinë e akuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve, se i pandehuri ka kryer veprën penale, për të cilën akuzohet.

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 493 të KPPRK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPRK-së, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, dhe atë: kallëzimi penal i Policisë së Kosovës nr.2017-AR-2974 të datës 09.11.2017, akt ekspertimi mjeko-ligjor në bazë të dokumenteve të çështjes nga Dr. Spec. B.C i datës 15.11.2017, ekspertiza e ekspertit të komunikacionit ing. Y.K të datës 21.11.2017, deklarata e të pandehurit e dhënë në procedurën paraprake, si dhe shkresat e tjera të lëndës janë prova të besueshme mbi bazën e të cilës vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata konstaton se i pandehuri A.S, është penalisht përgjegjës për kryerjen e veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë elementet e kësaj vepre penale.

Me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, gjykata u ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit sipas nenit 74 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës dhe paushallit gjyqësor, është marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.6 të KPPRK-së.

Në bazë të nenit 463 par.1 dhe 2, të KPPRK-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të neneve 365 dhe 495 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.665/2018 të dt. 23.04.2018

Procesmbajtësja,
Sanije Troshupa

G j y q t a r i
Rrustem Begolli

KËSHILLA JURIDIKE:

Të pandehurit ose mbrojtësit e tyre, në afat prej (8) ditëve, pas pranimit të këtij aktgjykimi–urdhri ndëshkimor, mund të paraqesin kundërshtim me shkrim ose me gojë.